



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA- REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Priljevoj / Pradato Received / Delivery	05-03	2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtetja Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKANSHTAK	3315/2023		1/3	



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.398/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi- Bajraktari-kryetare, Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Arben Mehmeti-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke vepruar sipas ankesës me numër A.nr.398/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi _____, nga Lipjani, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 04.04.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër me numër A.nr.398/2023 e datës 22.02.2023 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi _____, i punësuar në Komunën e Lipjanit sipas akt emërimit të datës 02.04.2012 në pozitën e punës “Inspektor i Trafikut”, në Komunën e Lipjanit më datë 22.02.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 1983/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 14.02.2023 të Udhëheqëses së Personelit në Komunën e Lipjanit, lidhur me refuzimin e kërkesës së ankuesit të datës 10.02.2023 për kompensim në mënyrë retroaktive të mjeteve të papaguara në emër të diferencës së koeficienti të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) nga data 20.11.2014 deri me datën 31.01.2023.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullore Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 28.02.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Komunën e Lipjanit. Ndërsa Këshilli, me datë

08.03.2023 përmes e-mailit ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 1983/2023 të datës 22.02.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Aktin e emërimit të datës 01.04.2011; Kërkesën me numër të referencës 1-120/04-7641 të datës 10.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të referencës 1-120/04-7641 të datës 14.02.2023; Shkresën me numër të referencës DASHC/MAP-04/1571 të datës 20.11.2014; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 2199/2023 të datës 28.02.2023; Përgjigjen në ankesë me numër të protokollit 2485/2023 të datës 08.03.2023; Vendimin e datës 26.01.2023; Përshkrimin e detyrave të punës të datës 09.10.2012; Listën e pagave për muajin Tetor-2022; Listën e pagave për muajin Janar 2023; Vendimin me numër A.nr.116/2022 të datës 19.01.2021 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës;

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Nga provat e administruara të lëndës rrjedhë së ankuesi është i punësuar në Komunën e Lipjanit në pozitën e punës *Inspektor i Trafikut*. I njëjti më datë 08.12.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ndërsa ky i fundit me Vendimin A.nr.116/2022 të datës 19.01.2023 ka përfunduar procedurën administrative lidhur me ankesën e ankuesit, me arsyetimin se duke marr parasysh se pretendimet ankimore të ankuesit kanë pas për objekt çështjen e realizimit të koeficientit të pagës, Kuvendi i Republikës së Kosovës, me datë 22.12.2022 ka aprovuar Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, i cili parasheh rregulla dhe kushte tjera për përcaktimin e pagës të të punësuarve në sektorin publik, duke përfshi edhe koeficientet dhe nivelet e koeficienteve të pagës të cilat ndryshojnë nga rregullat dhe sistemi aktual i pagave.

Ankuesi më datë 10.02.2023 ka parashtruar kërkesë tek Udhëheqësi i Personelit të Komunës së Lipjanit për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit për periudhën nga data 20.11.2014 deri me datën 31.01.2023 . Ndërsa, Udhëheqësi i Personelit përmes përgjigjes së datës 14.02.2023 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se Zyra e Personelit, nuk është kompetent për ndryshimin e koeficientit, pasi që ndryshimi i koeficientit munde të bëhet vetëm me zhvillimin e procedurave të rekrutimit siç është parapare me ligj.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 14.02.2023 të organit të punësimit, ankuesi me datë 22.02.2023 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, po me bazë të njëjtë gjegjësisht për njohjen e të drejtës për kompensimin retroaktiv të diferencës së koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në tetë (8) për periudhën 20.11.2014 deri me 31.01.2023.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh së



ankuesi me datë 02.04.2012 ka nënshkruar pa vërejtje aktin e emërimit për pozitën e punës "Inspektor i trafikut" me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dizeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndër marr asnjë veprim juridik në kuptim të harmonizimit të koeficientit të pagës me vendin e punës deri me datë 08.12.2022 duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohën kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 02.04.2012), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohet se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.

Theksuar si me sipër, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike:

Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS Lënda me numër A.nr.398/2023

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Lipjanit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.